URDHËR
Nr. 4, datë 13.1.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik"; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Mimoza Dhëmbi, me detyrë drejtor i përgjithshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të ushtrohen nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në një urdhër të dytë.
3. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj